REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije
Ministry of Finance
Arkiva - Arhiva - Archive
Njësia Org. / Org. Jedin. / Org. Unit: 01
Nr. Prot. / Br. Prot. / Prot. No: 1922
Nr. i faqeve / Broj stranica / No. pages: 2
Data / Datum / Date: 01/08/2016
Hyrëse PRISHTINË/A

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije / Ministry of Finance
Zyra e Ministrit / Kancelarija Ministra / Cabinet of the Minister

DATË/A:	01.08.2016
PËR/ZA/TO:	Kryetarët e Komunave, Drejtorët e Drejtorive Komunale, Zyrtarët Kryesor Financiar
CC:	z. Arban Abrashi, Ministër i Punës dhe Mirëqenies Sociale
NGA/OD/FROM:	Avdullah Hoti, Ministër i Financave
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Qarkorja Buxhetore 2017/02 për Komuna

Të nderuar Kryetarë të Komunave,

Po ju dërgojmë Qarkoren Buxhetore 2017/02 për komuna, përmes së cilës ju njoftojmë për strukturën e shpenzimeve për vitin 2017 dhe parashikimet për vitet 2018-2019, bazuar në kufijtë e financimit komunal të dhënë me Qarkoren Buxhetore 2017/01 të datës 13 maj 2016.

Kjo qarkore është nxjerrë në përputhje me kompetencat ligjore të Ministrisë së Financave, sipas nenit 20 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP). Udhëzimet e dhëna në këtë qarkore mbi strukturën e shpenzimeve bazohen në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2017-2019 (KASH), për të cilën Qeveria është dakorduar me Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN), ku përcaktohen niveli dhe struktura e të hyrave dhe shpenzimeve për buxhetin e përgjithshëm të Republikës së Kosovës.

Përveç strukturës së shpenzimeve, kjo qarkore ofron edhe sqarime shtesë për kriteret e aplikuara për shpërndarjen e pjesës prej 2.7% të grantit të përgjithshëm për 14 komuna me numër të popullsisë nën 22,000 banorë bazuar në amendamentimin e Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal të aprovuar në Kuvend më datë 14 korrik 2016 (Tabela 1).
Ju lutem të keni parasysh këto udhëzimeve në përgatitjen e propozim-buxhetit për komunën e juaj për vitin 2017 dhe parashikimet afatmesme 2018-2019.

Për informata shtesë apo ndihmesë lidhur me cilindo element të kësaj qarkore, ju lutem kontaktoni analistët e buxhetit në Departamentin e Buxhetit të Ministrisë së Financave. Dëshiroj t'ju njoftoj se në pjesën e dytë të muajit gusht, Ministria e Financave do të organizojë një numër të seminareve për zyrtarët e juaj ku do të jepen udhëzime më konkrete për përgatitjen e buxhetit komunal. Për orarin e këtyre seminareve do të njoftoheni me kohë.

Me respekt,

Avdullah Hoti
Ministër i Financave

1. Parimet bazë për përgatitjen e buxhetit komunal

Qeveria e Republikës së Kosovës është e përkushtuar të ruaj stabilitetin makro-fiskal dhe të realizojë Prioritetet Strategjike. Bazuar në Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal, komunat janë të obliguara që nga granti i përgjithshëm të ndihmojnë financimin e shpenzimeve për sektorin e arsimit dhe shëndetësisë. Po ashtu, komunat janë të obliguara që nga granti i përgjithshëm të ndihmojnë financimin e shpenzimeve për sektorin e shërbimeve sociale.

Në këtë qarkore që merr parasysh prioritetet e Qeverisë, është ruajtur raporti në mes të shpenzimeve rrjedhëse dhe shpenzimeve kapitale. Megjithatë, shpenzimet rrjedhëse, krahasuar me vitin paraprak janë rritur për 2.1 milion euro tek kategoria 'mallra dhe shërbime' në sektorin e arsimit parauniversitar. Kjo nënkupton rritje të grantit të arsimit për vitin 2017. Sa i përket shpenzimeve kapitale, kemi një rritje më të theksuar prej 15.8 milion euro.

Ndryshimet në numrin e stafit, që kanë ndodhur me proces të rishikimit të buxhetit 2016, do të reflektohen në buxhetit për vitin 2017 për Komunën e Obiliqit (2 punëtorë në administratën komunale) dhe Komunën e Lipjanit (5 punëtorë për shërbime rezidenciale).

Nisur nga nevoja për të ruajtur qëndrueshmërinë fiskale dhe menaxhim më efikas, efiçient dhe transparent të financave publike, organizatave buxhetore nuk ju lejohet të rrisin koeficientët e pagave dhe të shtojnë numrit e punëtorëve përtej kufizimeve në ligjin e buxhetit. Punësimi i stafit të ri duhet të bëhet në përputhje me masën monetare në dispozicion për kategorinë ekonomike *"Paga dhe Mëditje"* për vitin 2017. Duhet gjithashtu të respektohen dispozitat ligjore me rastin e pagesë të punës pas orarit të rregullt të punës. Çdo mosrespektim i këtyre kufizimeve nga organizata buxhetore është hyrje në obligim pa mbulesë, dhe rrjedhimisht paraqet shkelje të LMFPP-së dhe Ligjit vjetor të buxhetit.

Gjatë procesit të planifikimit të investimeve kapitale, secila komunë duhet fillimisht të planifikojë financimin e plotë të projekteve që janë në vijim e sipër. Pas kësaj, komunat mund të planifikojnë projekte të reja nëse këtë gjë e lejon buxheti i planifikuar, përfshirë edhe projektet me bashkëfinancim me ministritë e linjës apo me donatorët potencial (gjithnjë në pajtim me kërkesat për përputhjen e strukturës së financimit me tabelat buxhetore).

2. Shpërndarja e Kontigjencës për korrektimin e formulës së grantit të përgjithshëm

Me amendamentin e fundit të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, të aprovuar në Kuvendin e Kosovës më datë 14 korrik 2016, është korrektuar formula e grantit të përgjithshëm. Një pjesë prej 2.7% të grantit të përgjithshëm, që për vitin 2017 është 4 milionë euro, shpërndahet për 14 komunat që kanë numër të popullsisë nën 22,000 banorë.

Tabela në vijim tregon shpërndarjen e kësaj shume prej 4 milionë euro në përputhje me amendamentin e fundit të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal. Gjysma e kësaj shume ndahet për këto 14 komuna bazuar në numrin e banorëve që kanë dhe gjysma tjetër ndahet si shumë fikse të njëjtë për secilën komunë.

Tabela 1: Shpërndarja e kontigjencës për korrektim të formulës për 14 komuna

Nr	Komunat	Popullsia	Kriteret bazë		Total
			Sipas pjesëmarrjes së popullsisë	Shuma fikse proporcionalisht sipas Komunave	
1	Hani i Elezit	9,403	163,103.53	142,857.14	305,960.67
2	Junik	6,084	105,532.48	142,857.14	248,389.62
3	Leposaviq	13,773	238,905.13	142,857.14	381,762.27
4	Mamushë	5,507	95,523.89	142,857.14	238,381.03
5	Novo Bërdë	6,729	116,720.58	142,857.14	259,577.73
6	Obiliq	21,549	373,786.87	142,857.14	516,644.01
7	Shtërpcë	6,949	120,536.68	142,857.14	263,393.83
8	Zubin Potok	6,616	114,760.50	142,857.14	257,617.64
9	Zveçan	7,481	129,764.70	142,857.14	272,621.85
10	Gracanicë	10,675	185,167.52	142,857.14	328,024.66
11	Kllokot	2,556	44,336.13	142,857.14	187,193.27
12	Mitrovica veriore	12,326	213,805.60	142,857.14	356,662.75
13	Partesh	1,787	30,997.13	142,857.14	173,854.27
14	Ranillug	3,866	67,059.26	142,857.14	209,916.41
Total		**115,301**	**2,000,000.00**	**2,000,000.00**	**4,000,000.00**

3. Shërbimet Rezidenciale për vitin 2017

Shpenzimet Rezidenciale janë të shpërndara sipas kategorive ekonomike përkatëse brenda strukturës së përgjithshme të shpenzimeve të komunave (Tabela 3). Për të siguruar ofrimin e shërbimeve rezidenciale, komunat obligohen të zbatojnë arsyeshëm udhëzimet e MPMS-së për shpërndarjen e mjeteve buxhetore nëpër kategori të ndryshme ekonomike në nën-programin e Shërbimeve Rezidenciale brenda kufijve të financimit për Shërbimet Rezidenciale të cilat janë aprovuar nga Komisioni i Granteve dhe pasqyruar në Qarkoren Buxhetore 2017/01.

4. Shërbimet Sociale për vitin 2017

Pas aprovimit të kërkesës së MPMS-së me procesin e Rishikimit të Buxhetit për vitin 2016, sipas marrëveshjes së mirëkuptimit për transferin e kompetencave të shërbimeve sociale nga MPMS tek komunat Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan, janë bërë ndryshimet përkatëse duke rritur kufijtë buxhetor për vitin 2017 për këto tri komuna në total për 200,000 euro. Kjo shumë është reflektuar në kufijtë e strukturës së shpenzimeve sipas kategorive ekonomike për këto tri komuna. Si rezultat i kësaj, janë ulur kufijtë buxhetor të MPMS për këtë shumë krahasuar me Qarkoren 2017/01, duke përfshirë edhe zvogëlimin e numrit të punëtorëve për 26.

Tabela 2: Struktura e Shërbimeve sociale sipas kategorive ekonomike për vitin 2017

Nr.	Përshkrimi	Stafi	Paga dhe meditje	Mallra dhe shërbime	Shpenzime komunale	Subvencione dhe transfere	Shpenzime kapitale	Total
1	Leposaviq	7	46,000	10,000	4,000			**60,000**
2	Zubin potok	10	56,000	10,000	4,000			**70,000**
3	Zveçan	9	56,000	10,000	4,000			**70,000**
	Total	**26**	**158,000**	**30,000**	**12,000**	-	-	**200,000**

5. Struktura e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike

Gjatë planifikimit të buxhetit për vitin 2017 secila komunë duhet të respektoj strukturën e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike të lëshuar me këtë qarkore, të prezantuar në tabelën në vijim.

Tabela 3: Struktura e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike për vitin 2017 dhe vlerësimet për vitin 2018-2019 për komuna

Nr.	Komunat	QB 2017/01	QB 2017/02			Viti 2017							Viti 2018			Viti 2019		
		Total Financimi Komunal për vitin 2017	Shpërndarja e Kontigjencës për korrektim të formulës së grantit të përgjithshëm	Transferi i kompetencave për Shërbime Sociale	Total Financimi Komunal për vitin 2017	Stafi 2017	Paga dhe meditje	Mallra dhe shërbime	Shpenzime komunale	Subvencione dhe transfere	Shpenzime kapitale	Total shpenzimet 2017	Shpenzime operative	Shpenzime kapitale	Total shpenzimet 2018	Shpenzime operative	Shpenzime kapitale	Total shpenzimet 2019
1	Deçan	8,176,265			**8,176,265**	875	5,122,049	773,005	106,130	66,178	2,108,902	**8,176,265**	6,089,585	2,298,119	**8,387,704**	6,111,802	2,458,142	**8,569,944**
2	Dragash	7,550,914			**7,550,914**	776	4,233,292	605,220	130,000	24,663	2,557,739	**7,550,914**	5,011,542	2,763,782	**7,775,325**	5,029,904	2,930,762	**7,960,666**
3	Ferizaj	26,480,591			**26,480,591**	2,387	14,347,051	2,947,314	452,680	599,752	8,133,794	**26,480,591**	18,409,044	8,628,033	**27,037,077**	18,471,274	9,058,422	**27,529,696**
4	Fushë Kosovë	9,540,836			**9,540,836**	720	4,373,544	604,569	150,000	274,675	4,138,049	**9,540,837**	5,421,763	4,304,579	**9,726,342**	5,440,733	4,469,383	**9,910,116**
5	Gjakovë	21,229,849			**21,229,849**	2,258	13,000,526	1,798,036	561,899	439,982	5,429,406	**21,229,849**	15,856,848	5,880,955	**21,737,803**	15,913,237	6,268,326	**22,181,563**
6	Gjilan	22,657,746			**22,657,746**	2,448	14,710,814	2,629,598	562,200	554,086	4,201,047	**22,657,745**	18,520,523	4,601,623	**23,122,147**	18,584,331	4,959,896	**23,544,227**
7	Gllogoc	13,141,239			**13,141,239**	1,312	7,857,892	1,064,594	157,860	212,063	3,848,830	**13,141,239**	9,326,502	4,113,473	**13,439,975**	9,360,585	4,332,109	**13,692,694**
8	Hani i Elezit	2,100,573	305,960.67		**2,406,534**	222	1,393,609	180,551	44,533	51,104	736,737	**2,406,534**	1,675,844	474,886	**2,150,729**	1,681,888	511,175	**2,193,063**
9	Istog	9,357,206			**9,357,206**	969	5,799,714	853,700	117,000	223,813	2,362,979	**9,357,206**	7,019,390	2,560,934	**9,580,324**	7,044,546	2,726,119	**9,770,665**
10	Junik	1,285,509	248,389.62		**1,533,898**	156	1,000,466	130,012	30,000	5,755	367,666	**1,533,899**	1,170,573	148,406	**1,318,979**	1,174,913	172,088	**1,347,001**
11	Kaçanik	7,039,281			**7,039,281**	798	4,831,215	539,350	139,000	204,690	1,325,026	**7,039,281**	5,735,216	1,477,464	**7,212,680**	5,756,171	1,603,267	**7,359,438**
12	Kamenicë	7,640,425			**7,640,425**	1,172	6,766,498	600,002	140,005	9,125	124,795	**7,640,425**	7,544,988	298,121	**7,843,109**	7,574,337	438,958	**8,013,295**
13	Klinë	8,645,555			**8,645,555**	944	5,656,411	660,364	151,258	65,767	2,111,755	**8,645,555**	6,558,341	2,293,768	**8,852,109**	6,582,876	2,444,115	**9,026,990**
14	Leposaviq	3,768,510	381,762.27	60,000	**4,210,272**	555	1,469,785	217,492	64,000	69,973	2,389,022	**4,210,272**	1,767,427	2,140,616	**3,908,044**	1,773,603	2,246,273	**4,019,876**
15	Lipjan	14,025,259			**14,025,259**	1,522	8,772,802	856,366	198,390	329,067	3,868,633	**14,025,258**	10,194,688	4,136,383	**14,331,071**	10,232,739	4,364,628	**14,597,367**
16	Malisheve	12,866,847			**12,866,847**	1,287	7,694,744	816,312	305,000	65,767	3,985,024	**12,866,847**	8,915,208	4,232,999	**13,148,207**	8,948,584	4,433,959	**13,382,542**
17	Mamusha	1,575,018	238,381.03		**1,813,399**	136	899,615	202,891	23,000	2,466	685,427	**1,813,399**	1,131,875	489,805	**1,621,681**	1,135,777	523,804	**1,659,581**
18	Mitrovicë	16,684,897			**16,684,897**	1,969	11,410,884	1,305,856	465,000	545,043	2,958,114	**16,684,897**	13,776,291	3,280,970	**17,057,260**	13,825,785	3,554,072	**17,379,857**
19	Novobërdë	2,072,276	259,577.73		**2,331,854**	340	1,754,425	151,088	46,000	9,521	370,820	**2,331,854**	1,968,645	155,796	**2,124,441**	1,976,255	191,828	**2,168,083**
20	Obiliq	5,544,435	516,644.01		**6,061,079**	627	3,664,936	367,452	123,000	138,799	1,766,892	**6,061,079**	4,310,088	1,348,930	**5,659,018**	4,325,984	1,436,033	**5,762,018**
21	Pejë	22,464,703			**22,464,703**	2,225	13,194,668	2,527,947	671,924	250,000	5,820,164	**22,464,704**	16,701,787	6,285,373	**22,987,159**	16,759,018	6,693,553	**23,452,571**
22	Podujevë	19,284,786			**19,284,786**	1,976	11,631,746	1,287,178	324,500	568,883	5,472,479	**19,284,786**	13,862,774	5,887,328	**19,750,102**	13,913,226	6,224,843	**20,138,069**
23	Prishtinë	62,023,630			**62,023,630**	4,725	28,044,512	7,637,910	1,793,000	1,816,810	22,731,398	**62,023,630**	39,413,908	23,612,995	**63,026,903**	39,535,550	24,588,909	**64,124,458**
24	Prizren	38,656,659			**38,656,659**	3,101	18,874,056	3,311,386	1,081,200	477,615	14,912,402	**38,656,659**	23,826,146	15,810,374	**39,636,520**	23,908,011	16,573,476	**40,481,487**
25	Rahovec	11,908,739			**11,908,739**	1,160	7,028,178	754,119	270,500	123,313	3,732,629	**11,908,739**	8,206,602	3,992,136	**12,198,739**	8,237,087	4,204,663	**12,441,749**
26	Shtërpcë	3,314,215	263,393.83		**3,577,609**	519	1,968,980	349,118	81,625	2,877	1,175,009	**3,577,609**	2,411,143	958,601	**3,369,744**	2,419,683	999,225	**3,418,908**
27	Shtimë	6,364,152			**6,364,152**	660	3,922,416	564,705	169,650	113,037	1,594,344	**6,364,152**	4,786,826	1,719,317	**6,506,142**	4,803,839	1,820,813	**6,624,652**
28	Skenderaj	11,932,215			**11,932,215**	1,370	7,372,119	983,432	200,440	180,642	3,195,583	**11,932,215**	8,768,618	3,430,526	**12,199,144**	8,800,594	3,622,727	**12,423,321**
29	Suharekë	13,783,632			**13,783,632**	1,309	8,027,679	1,075,337	262,000	280,999	4,137,617	**13,783,632**	9,680,845	4,413,268	**14,094,113**	9,715,664	4,646,203	**14,361,867**
30	Viti	10,019,298			**10,019,298**	1,151	6,928,119	953,534	200,862	197,712	1,739,071	**10,019,298**	8,310,285	1,952,014	**10,262,299**	8,340,336	2,126,365	**10,466,701**
31	Vushtrri	15,902,354			**15,902,354**	1,584	9,532,316	1,562,755	241,042	182,914	4,383,326	**15,902,353**	11,560,384	4,701,851	**16,262,235**	11,601,730	4,971,800	**16,573,530**
32	Zubin Potok	1,986,208	257,617.64	70,000	**2,313,826**	410	740,746	202,697	67,062	41,104	1,262,217	**2,313,826**	984,580	1,074,877	**2,059,457**	987,550	1,130,442	**2,117,992**
33	Zveçan	1,860,830	272,621.85	70,000	**2,203,452**	351	422,669	176,819	64,000	65,767	1,474,197	**2,203,452**	660,846	1,267,274	**1,928,120**	662,436	1,319,706	**1,982,142**
34	Graçanicë	6,806,051	328,024.66		**7,134,075**	592	2,623,151	602,120	150,000	180,859	3,577,945	**7,134,075**	3,567,511	3,339,925	**6,907,436**	3,578,889	3,429,508	**7,008,397**
35	Kllokot	859,128	187,193.27		**1,046,321**	124	672,335	99,191	17,200	6,644	250,951	**1,046,321**	798,287	77,682	**875,970**	801,204	89,282	**890,486**
36	Mitrovica veriore	5,181,500	356,662.75		**5,538,163**	833	912,928	617,283	146,927	156,196	3,704,829	**5,538,163**	1,837,295	3,445,140	**5,282,435**	1,841,255	3,522,509	**5,363,764**
37	Partesh	832,686	173,854.27		**1,006,540**	145	795,873	136,246	40,013	1,644	32,764	**1,006,540**	818,496	30,000	**848,496**	831,421	30,000	**861,421**
38	Ranillug	1,466,848	209,916.41		**1,676,765**	189	984,810	131,125	20,000	36,994	503,836	**1,676,765**	1,177,201	324,626	**1,501,828**	1,181,473	349,196	**1,530,669**
	Total	**436,030,866**	**4,000,000**	**200,000**	**440,230,866**	**43,897**	**248,437,572**	**40,276,675**	**9,768,900**	**8,576,299**	**133,171,420**	**440,230,866**	**307,777,916**	**137,952,950**	**445,730,866**	**308,864,289**	**145,466,577**	**454,330,866**
	Kontigjenca per korrektim te formules se grantit te pergjithshem	**4,000,000**																
	Total	**440,030,866**																

6. Forumet me autoritetet komunale mbi zhvillimin e procesit buxhetor komunal

Departamenti i Buxhetit i Ministrisë së Financave do të organizojë forume me autoritetet komunale lidhur me procesin buxhetor komunal për vitin 2017-2019. Prandaj, përmes trajnimeve shtesë do të ofrohen udhëzime më specifike për zyrtarët e buxhetit komunal rreth hartimit të buxhetit për secilën nga fazat kyçe, përfshirë aplikimin e sistemeve elektronike BDMS dhe PIP. Prandaj, ju inkurajojmë që të vazhdoni me procesin e fuqizimit të kapaciteteve për planifikim të shpenzimit, në veçanti shpenzimeve kapitale, me qëllim të masksimalizimit të përfitimeve ekonomike nga projektet me interes publik.

7. Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinor (BPGJ)

Komunat duhet të adresojnë buxhetimin e përgjegjshëm gjinor sipas udhëzimeve të dhëna me Qarkoren Buxhetore 2017/01.

8. Dorëzimi i propozim-Buxhetit Komunal për vitin 2017-2019

Pas aprovimit të Buxhetit për vitin 2017-2019 nga Kuvendet Komunale, komunat duhet të dorëzojnë atë në Departamentin e Buxhetit në Ministrinë e Financave deri më datë 30 shtator 2016. Buxheti duhet të përmbajë dokumentet si në vijim:

- Shkresa përcjellëse nga Kryetari i Komunës lidhur me aprovimin e propozim-buxhetit nga Kuvendi Komunal për periudhën 2017-19,
- Vendimi i Kuvendit Komunal mbi aprovimin e propozim-buxhetit komunal për periudhën 2017-2019,
- Tabela 4.1 - plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve totale të komunës për periudhën 2017-2019 (kopje e shtypur nga sistemi BDMS, e vulosur dhe e nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe ZKF),
- Tabela 4.2 - financimi i projekteve kapitale për vitin 2017 dhe projekteve kapitale shumëvjeçare për vitin 2018-2019 (shtypur nga sistemi PIP, e vulosur dhe e nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe ZKF),
- Tabela 4.3 – plani afatmesëm i të hyrave totale të buxhetit komunal nga grantet qeveritare dhe të hyrat vetanake (shtypur nga sistemi BDMS, e vulosur dhe e nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe ZKF).